



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:235689
Datë: 20.01.2025
Numri i dokumentit: 06727986

C-IV.-14-4182

F M nga Prishtina.

Ankuesi:

Kundër:

E paditura:

N.SH “Amortizatorët”, e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Hajrie Shala, me dt.17 janar 2025, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

1.REFUZOHET si e pa bazuar ankesa dhe **VËRTETOHET** vendimi i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së nr.PRN047-0684 i dt.23 maj 2014, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

2.Ankuesja lirohet nga pagesa e taksës gjyqësore.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me dt.10 qershor 2014, ankuesi ka ushtruar ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovë (më tej “Dhoma e Posaçme”) kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit (më tutje AL) me nr.PRN047-0684 i dt.23 maj 2014, me të cilin i është refuzuar kërkesa për kompensim për anulimin e ndarjes së mjeteve financiare të inkasuara nga pagesa e qirasë së ambienteve të NSH-së dhe si rrjedhojë kompensimin e një shume shtesë të pa përcaktuar nga N.SH “Amortizatorët” (në likuidim). Ankuesi në ankesë ka deklaruar se të njëjtën e paraqet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të ligjit mbi AKP dhe për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Ka shtuar se gjendja faktike nuk është vërtetuar sepse objektet deri në momentin e privatizimit kanë qenë në pronësi shoqërore, çka d.m.th se kanë të drejtë të gjithë

punëtorët në shfrytëzimin e mjeteve prej qirave. Ankesës i ka bashkangjitur: Kopjen e vendimit të kundërshtuar, Kopjen e formularit të kërkesës për likuidim, Kopjen e kontratës së punës dt.03.10.2001.

Me dt.27 nëntor 2017, e paditura AKP-ja ka parashtruar mbrojtje në ankesë, në të cilën pohoi se AKP e kundërshton në tërësi kërkesën e ankuesit duke shtuar se nuk autoritet për të anuluar atë vendim të cilin e ka kundërshtuar ankuesi, pasi që AL në përputhje me detyrimet dhe përgjegjësit e tij të parapara me nenin 18 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së nr.04/L-034 nuk ka kompetencën e duhur për të anuluar vendimin për shpërndarje. Ka kërkuar që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet si e pa bazuar. I ka bashkangjitur: Kopjen e kërkesës për emërimin të anëtarëve të AL, Kopjen e shkresës së kryesuesit të Bordit Menaxhues të NSH Amortizatorët, Kopjen e Raportit të Komisionit për shpërndarjen e mjeteve të inkasuara nga qiraja, Kopjen e vendimit nr.91/2 dt.05.04.2011, Kopjen e ekstrakt procesverbali nr.36/1 dt.21.02.2011, Kopjen e shkresës nr.37/1 dt.21.02.2011, Kopjen e vendimit nr.379/1 dt.23.12.2010.

Me dt.09 gusht 2024 gjykata ka lëshuar një urdhër për ankuesin, përmes të cilit ka kërkuar nga i njëjti që të bëjë dorëzimin e provave shtesë në mbështetje të ankesës së dt.10 qershor 2014 si dhe provave tjera shtesë me të cilat vërtetohet vlera e mbetur borxh. Ankuesi e ka pranuar urdhrin e lëshuar nga gjykata me dt.14 gusht 2024, por deri në kohën e përpilimit të vendimit nuk i është përgjigjur të njëjtit.

Arsyetimi ligjor

Ankesa e ankuesit refuzohet si e pabazuar, dhe vërtetohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit.

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par.1 pika 1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 par.2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se palët që pretendojnë një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësas apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa par.3 parasheh se palët që pretendojnë një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse palët e tilla dështojnë që të paraqesin apo dorëzojnë provat e tilla, atëherë vlerësohet se palët nuk kanë përmbushur barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Në këtë rast gjykata gjen se, nuk është kontestues fakti se ankuesi ka qenë punëtor i NSH-së, por nga shkresat e lëndës gjykata vie në përfundim se ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmojë se duhet të bëhet anulimi i ndarjes së mjeteve financiare të inkasuara nga pagesa e qirasë së ambienteve të NSH-së. Ankuesi ka bërë dorëzimin e Kopjes së vendimit të kundërshtuar, Kopjen e formularit të kërkesës për likuidim, Kopjen e kontratës së punës dt.03.10.2001. Ankuesi e kishte paraqitur ankesën vetëm me provat e lartë përmendura dhe edhe pse ka qenë e njoftuar në bazë të vendimit të kundërshtuar për refuzimin e kërkesës së tij.

Gjykata gjeti se në bazë të Raportit të Komisionit për Shpërndarjen e Mjeteve të Inkasuara nga Qiraja e UNMIK dt.04 nëntor 2010, punëtorët e NSH “Fabrika e Amortizatorëve”, shuma e qirasë së shfrytëzimit të objekteve – pronë e NSH-së , në shumë totale prej 2,537.000.00€, e cila është shpërndarë në favor të Administratës Tatimore të Kosovës, në emër të obligimeve dhe ndëshkimeve dhe shuma e mbetur prej 2,160.380.48€ u është shpërndarë punëtorëve të NSH-së. Kështu, ankesat e punëtorëve ndaj vendimit ishin shqyrtuar nga ky Komision dhe me anë të vendimit dt.07 shkurt 2011, i cili është publikuar në tabelën e shpalljes së NSH-së dhe ankesat ndaj tij janë shqyrtuar nga Bordi Menaxhues i NSH-së me anë të vendimit të dt.05 prill 2011. Bazuar në këtë, ankuesi edhe si çdo punëtor tjetër është njoftuar në mënyrë të rregullte mbi shpërndarjen e mjeteve financiare dhe ka pas të drejtë që të paraqes ankesë.

Nga kjo gjykata vjen në përfundim që parashtruesi i ankesës nuk i ka përmbushur kriteret themelore të ankesës. Ankuesi do të mund të dorëzonte prova relevante në mbështetje të pretendimeve të tij ankimore, siç janë dokumentet me anë të së cilave do të dëshmonte se përse duhet të bëhet anulimi i mjeteve të shpërndara e të inkasuara nga qiraja e objekteve të ndërmarrjes. Gjykata gjen se, në mungesë të dëshmive, pretendimet e ankuesit lidhur me të drejtën e tij të pretenduar, nuk janë të mbështetura në provat e nevojshme materiale. Edhe pse ankuesit iu dha mundësia që edhe përmes urdhrit të parashtruar nga gjykata të bëjë dorëzimin e provave shtesë në mbështetje të pretendimeve ankimore, por ankuesi nuk e bëri një gjë të tillë, duke vendosur që të mos i përgjigjet gjykatës, andaj bazuar në provat e dorëzuara nga ankuesi ankesa e tij është refuzuar si e pabazuar.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54 par.1 dhe 74 par..4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Taksat gjyqësore

Në bazë të nenit 62.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, secila palë do t'i bart shpenzimet e veta procedurale.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim tek Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh nga data e pranimit. Ankesa duhet të parashtrohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gj y q t a r j a
Hajrie Shala